

VLERËSIMI I PUNËS SHKENCORE DHE I REVISTAVE SHKENCORE

EVALUATION OF SCIENTIFIC WORK AND SCIENTIFIC JOURNALS

Musa RIZAJ, Ekrem BEQIRI¹, Nebi CAKA²

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Mitrovicë

² Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Prishtinë

Abstrakt

Puna shkencore hulumtuese është veprimtari që ka për qëllim arritjen e rezultateve të caktuara shkencore. Meqë arritjet shkencore dallojnë si në pikëpamje të cilësisë, po ashtu edhe të relevancës, është më rëndësi që ato të vlerësohen.

Në gjithë këtë problematikë, vlerësimi i punës shkencore (kompetencës shkencore) është një segment i rëndësishëm dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në përcjelljen, marrjen dhe krahasimin e arritjeve shkencore me rrjedhat e reja zhvillimore në botë. Vlerësimi i aktiviteteve shkencore (kualitativ dhe kuantitativ) duhet të jetë i matshëm dhe të ketë bazën përkatëse ligjore të rregulluar. Në punim është analizuar gjendja e punës shkencore në Kosovë dhe është dhënë një vështrim kritik i qasjes ndaj vlerësimit të saj dhe të trajtimit të punës shkencore në përgjithësi. Puna shkencore në vendin tonë kërkon reforma rrënjësore, krijimin e një rrjeti

institucional, zgjidhjen e bazës materiale, formimin e bazës së të dhënave, vlerësimin etj.

Në punim shtrohet pasqyrimi i elementeve themelore të monitorimit, komunikimit dhe vlerësimit të rezultateve, nëpërmjet një koncepti i cili ka si synim ngritjen e një modeli praktik për vlerësimin e punës shkencore, të cilin tashmë e kanë ndërtuar shumë vende të botës.

Fjalët kyçe: Puna shkencore, hulumtimi shkencor, vlerësimi, kompetenca.

Hyrje

Numri më i madh i punonjësve shkencorë në Kosovë punon në Akademinë e Shkencës dhe Arteve të Kosovës, Universitetin e Prishtinës, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, në INKOS dhe në disa institute pranë Ministrive. Organizimi i këtyre institucioneve është ai i dhjetëvjeçarit

të kaluar e nuk është në përputhje me kërkesat e globalizimit dhe pa ndonjë reformë të mirëfilltë. Këto institucione kryesisht merren me shkencat shoqërore dhe të natyrës, ndërsa inxhinieria është shumë pak e pranishme. Prandaj edhe rezultatet e prodhuara nuk vërehen, janë më shumë individuale, nuk evidentohen dhe ndërmarrësi nuk tregojnë interes për to. Faktorët që kanë ndikuar në këtë gjendje janë të shumtë, duke filluar nga strukturimi, pajisjet laboratorike, mbështetja financiare, llogaridhënia etj.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është institucioni përgjegjës për rregullimin e kësaj fushe. Sipas ligjit, për veprimtarinë shkencore-hulumtuese ndahen 0.9% e buxhetit të Kosovës. Nuk janë këto mjete që nuk mund të krahasohen me ato të rajonit në këtë buxhet të vogël të Kosovës, por si shfrytëzohen dhe si përndahen në rrjetin e institucioneve.

Puna shkencore është forcë prodhuese, rezultatet e saj janë promotor i zhvillimit ekonomik, ajo pra është me rëndësi për zhvillimin e përgjithshëm njerëzor. Në këtë zinxhir të aktiviteteve në punën hulumtuese shkencore, do të flasim për një segment të rëndësishëm të saj, për vlerësimin e rezultateve të punës shkencore. Vlerësimi duhet bërë me mjete të njohura, të rregulluara dhe transparente. Kjo kryhet në mënyrë që çdo punonjësi shkencor këto të dhëna t'i shërbejnë për ngritje të kompetencës personale dhe të kontribuohet

në zhvillimin e përgjithshëm tekniko-teknologjik dhe ekonomik të vendit. Është zgjedhur ky pozicion për ta elaboruar sepse sot, në shumë institucione mësimore dhe shkencore në vend dhe jashtë tij, është objekt diskutimi mënyra dhe kriteret e vlerësimit të rezultateve të punës shkencore, diskutim shpesh i përcjellë me kundërtënie.

1. Publikimi i rezultateve të punës shkencore

Rezultatet e punës shkencore janë me interes vetëm atëherë kur publikohen. Mënyra, forma dhe vendi i publikimit janë përcaktues të vlerës së një pune shkencore. Publikimi i rezultateve të punës shkencore zakonisht bëhet nëpërmjet publikimeve të punimeve në revista shkencore, kumtesave në tubime shkencore, patentave, monografive, etj.

Disiplinat e ndryshme shkencore mund të kenë dallime në mënyrën e publikimit të rezultateve të punës shkencore. Publikimi i rezultateve në revista shkencore është forma më standarde e këtij aktiviteti shkencor për të gjitha shkencat. Secili punëtor shkencor ka si synim publikimin e rezultateve të fituara në revistën shkencore e cila i siguron një publicitet më të madh, besueshmëri në rezultatit e publikuar etj. Cilat janë ato revista? Në vende të zhvilluara secila revistë shkencore, falë bazës së ndërtuar bibliografike ka faktorin e ndikimit (anglisht: *impact factor*) të saj.

Punëtorët shkencorë të vendeve të vogla, pra edhe ata nga Kosova dhe Shqipëria, rezultatet e punës shkencore i publikojnë në revistat shkencore ndërkombëtare. Kjo e dhënë i ka përparësitë dhe të metat e saj. Si përparësi mund të merren se po krijohet një komunikim më i gjerë ndërmjet krijuesve, rezultati ka kaluar një formë më stabilë të vlerësimit cilësor, punimi ndodhet në bazën bibliografike të të dhënave. Ndërsa pjesa tjetër që nuk e favorizon këtë aktivitet është, siç thotë Garfield-i: “atyre u ka pamundësuar që të kenë revista shkencore nacionale të pranuar”.

Në bazën bibliografike të të dhënave ISI, SCI, nuk është e referuar asnjë revistë nga fusha e inxhinierisë nga Kosova dhe Shqipëria. Revistat e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (“Kërkime”) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe buletinet e njëjësive akademike nëpër universitete, nuk kanë arritur të jenë të referuara në çfarëdo qoftë forme në këto baza të të dhënave.

Institucionet që janë përgjegjëse për punën shkencore, në radhë të parë MASHT-i, duhet të bëjnë përpjekje që të mbështesin revistat shkencore të fushave përkatëse dhe të sigurojnë referimin e tyre në bazën bibliografike të të dhënave ISI, si dhe të nxisin ndërtimin e bazës bibliografike të të dhënave në Kosovë, në mënyrë që të jemi në hap me shkencën evropiane dhe botërore. Inxhinieria e Kosovës doemos duhet të

ketë një revistë të tillë. Vetëm kështu, duke i shfrytëzuar të dhënat dhe analizat bibliometrike, mund të ndihmojmë në ngritjen e cilësisë së punës shkencore. Vetëm kështu mund të matim objektivisht kontributin e secilit individ dhe institucion.

2. Vlerësimi i punës shkencore

Vlerësimi i punës shkencore individuale dhe të institucioneve shkencore si tërësi ka të bëjë më një bilanc të rezultateve, i cili e shpreh kontributin e dhënë në një fushë të caktuar të punëtorit shkencor. Këto rezultate duhet të jenë të matshme dhe të përpunuara sipas një metodologjie përkatëse. Numri i punimeve profesionale dhe shkencore të publikuara nga punëtorët shkencorë (individualisht ose si grup autorësh), a publikimi nga institucioni, është kriteri më i përhapur i vlerësimit të një pune shkencore. Problemet fillojnë kur kërkohen rezultatet krahasimtare – cilësia e punës shkencore dhe e punëtorit shkencor. Vetë numërimi i punimeve dhe insistimi vetëm në numërim ka sjellë te shumë shkencëtarë dilema, duke kërkuar “sa punime” i ka publikuar. Kështu në rregullimin e bazës ligjore për vlerësimin e punës shkencore dhe cilësinë e revistës shkencore nuk duhet bazuar vetëm në sasinë, por edhe në cilësinë e punimit, përkatësisht të revistës. Prandaj për vlerësimin e punës shkencore duhet të kërkohet edhe kriteri kualitativ i vlerësimit me të dhëna nga bazat bibliografike. Ky

vlerësim, që njihet edhe si vlerësim kuantitativ, pasqyron edhe cilësinë e një pune shkencore dhe na jep rezultatet më domethënëse. Por, asnjëri kriter i vlerësimit të punës shkencore nuk i plotëson në tërësi kërkesat për një vlerësim objektiv. Secila mënyrë e vlerësimit ka përparësitë dhe të metat e saj dhe vetëm kombinimi i tyre dhe shfrytëzimi i sa më shumë kriterëve mund të kontribuojë në një vlerësim objektiv.

2.1. Vlerësimi kualitativ

Vlerësimi i parë i një pune shkencore është vlerësimi kualitativ i saj përmes vlerësimit të ekspertëve – recensionit.

Recensioni është vlerësimi që japin kompetentët e një fushe të caktuar për një punë shkencore. Është metoda më e vjetër e vlerësimit dhe ka ende shumë përkrahës në fushën shkencore. Vlerësimi i punës shkencore me metodën e recensionit nuk është i mjaftueshëm, posaçërisht në vendet e vogla, ku zgjedhja e recensentëve objektivë është vështirësuar. Me këtë vlerësim është vështirë të fitohet pasqyrë reale për një punë shkencore të mirëfilltë, gjegjësisht të pengohet publikimet e rezultateve të dyshimta dhe të pavlerë. Në vendet e zhvilluara dhe me treg të gjerë shkencor ky problem është zbutur pak duke angazhuar recensentët e “panjohur”.

2.2. Vlerësimi kuantitativ

Që recensionit të mos këtë elemente të njëanshmërisë, pasaktësisë, përzjerje të konfliktit të interesave, është e nevoj-

shme që recensenti gjatë vlerësimit të punës shkencore të shfrytëzojë edhe tregues sasiore të vlerësimit. Këta tregues bazohen në të dhënat bibliometrike dhe shërbejnë për vlerësimin e punës shkencore. Këtu numërohen tregues sasiore si:

- numri i punimeve shkencore të botuara në revistat me recension
- monografitë e publikuara me recension
- tekstet dhe kapitujt nga vëllimet me recension
- ftesat për ligjërata në tubimet shkencore
- punimet e publikuara në tubimet shkencore (konferenca, simpoziume, kongrese)
- projektet e punuara
- citimi i punimeve dhe revistave
- faktori i ndikimit të revistës etj.

Të dhënat shkencore bibliografike duhen dalluar nga të dhënat e tjera shkencore që mund të jenë me interes, si: informacionet për tekstet në biblioteka, fondet, revistat etj. Për vlerësim zakonisht shfrytëzohen të dhënat bibliografike shkencore të cilat referojnë (indeksojnë) pjesë të punimeve apo revistave shkencore në publikimet ndërkombëtare të indeksuara dhe të dhënat për citimin e punimeve. Vlerësimi kuantitativ me treguesit e paraqitur është një epërsi me shumë elemente në raport me vlerësimin kualitativ, në veçanti në vendet të cilat nuk kanë treg të zhvilluar shkencor.

3. Vlerësimi i revistës shkencore

Revistat shkencore, si dhe shkenca në Kosovë (për arsye të njohura), nuk kanë ndonjë traditë, përveç disa revistave nga shkencat shoqërore. Fatkeqësia nuk qëndron aty, por qëndron në faktin se kjo fushë e publikimit të punës shkencore është lënë pas dore dhe nënçmohet, nuk ka financim dhe mungon strategjia për ngritjen cilësore të revistave.

Përfshirja në procesin e Bolonjës, si një proces që krijon vlera në fushën e shkencës dhe punës shkencore, vlerësimin e punës shkencore e sheh si faktor me ndikim në cilësinë e kësaj fushe. Në këtë zinxhir të aktiviteteve shkencore, revista shkencore relevante është dhe mbetet një burim i pazëvendësueshëm informacioni për arritjet shkencore. Revista shkencore është shtylla qendrore e shkencës dhe produkti final i publikimit të punës shkencore për individë dhe grupe punëtorësh shkencorë. Në revistë mund të shihet dhe përcillet gjendja dhe niveli në një fushë shkencore, ajo është institucion në të cilën këto rezultate mund të kenë një kontinuitet të natyrshëm. Zhvillimi i punës shkencore hulumtuese, rritja e numrit të hulumtimeve dhe hulumtuesve dhe formimi i disiplinave të reja shkencore ka sjellë deri të rritja e numrit të revistave shkencore dhe publikimeve të tjera. Kjo formë e publikimit njihet edhe si publikim primar. Të përcjellësh gjithë këtë spektër të informatave shkencore është punë mjaft e vështirë

dhe e pamundur pa përpunimin, referimin dhe indeksimin e tyre. Kjo formë e publikimit njihet si publikim sekondar. Pa këto të dhëna nuk ka as vlerësim të matshëm të punës shkencore. Rritja dhe zhvillimi i shkencës dhe i hulumtimeve shkencore, numri gjithnjë e më i madh i hulumtuesve dhe shkencëtarëve të fushave të ndryshme ka shkaktuar një rritje eksponenciale të numrit të revistave, librave, përmbledhjeve nga tubimet shkencore etj. Por nuk është vetëm kjo rëndësia e revistës, ajo është edhe në mbështetjen e procesit të punës shkencore – edukimit shkencor.

Modeli eventual për vlerësimin e revistës “në tregun shkencor të vogël”, është mirë të bazohet në kriteret që përcaktohen për përfshirje të revistës në sistemin ndërkombëtar të informatave (ISI). Këto kriteret – përfshirja në bazën e citimit të të dhënave janë të mjaftueshme për cilësinë e revistës dhe ndikimin e saj në përparimin e punës kërkimore shkencore.

Revista shkencore duhet të jetë organ i institucioneve përkatëse kompetente dhe të mbështetet në kriteret të caktuara. Në këto kriteret mund të numërohen: pranimi i punimeve, botimi i rregullt kohor, fusha e përcaktuar që përfaqëson, këshilli redaktues kompetent dhe recensentët, gjuha në të cilën botohet, faktori i ndikimit, koha e referimit, etj., të cilët e mbajnë dhe e fuqizojnë autoritetin e revistës. Revistat që kanë faktor të lartë ndikimi këto kriteret i kanë të përpunuara dhe

e ruajnë cilësinë e saj në vazhdimësi. Në tabelën 1 është dhënë renditja dhe faktori i ndikimit (*impact factor*) i disa revistave nga fusha e metalurgjisë dhe përgatitjes së lëndës së parë minerare (për vitin 2006).

Kështu vlerësimi i revistave në vendet që kanë të zhvilluar të gjithë strukturën e punës shkencore bëhet përmes faktorit të ndikimit i cili llogaritet në bazë të referimit të dhënave shkencore në ISI (SCI, SSCI, A&HCI) nga Filadelfia. Faktori i ndikimit llogaritet sipas metodologjisë së propozuar nga Garfield dhe paraqet mesataren e citimit të revistës për dy vitet paraprake, në bazat e të dhënave bibliografike, dhe për vitin 2006 mund të llogaritet sipas barazimit:

$$FN = \frac{\text{Numri i punimeve cituar më 2006, për punimet e botuara më 2004-05}}{\text{Numri i përgjithshëm i punimeve të botuara në vitet 2004-2005}}$$

Ky faktor edhe përkundër të metave që ka (i favorizon revistat me numër të

madh botimesh) është kriter shumë i rëndësishëm për vlerësimin e revistës shkencore por nuk mund të përdoret për vlerësimin e punës shkencore individuale.

Shfrytëzimi i FN-së për vlerësimin e revistës, për vendet me treg të vogël shkencor, ku bëjnë pjesë edhe Kosova e Shqipëria, është i pamundur. Kosova, besojmë edhe Shqipëria, nuk kanë asnjë revistë shkencore nga shkencat shoqërore dhe shkencat e natyrës, e cila referohet në bazën e të dhënave ISI apo në JCR. Përgjegjës për këtë gjendje janë institucionet qeverisëse të vendit, të cilat e kanë për detyrë të orientojnë dhe të mbështesin punën shkencore hulumtuese. Ndërsa për kualitetin e revistës përgjigjet këshilli botues.

Faktori i ndikimit (*impact factor*) te disa revista për fushën e metalurgjisë dhe të përgatitjes së lëndës së parë minerare (për vitin 2006):

Bazën shkencore bibliografike, sipas standardeve tash të njohura, e mbuloj-

Revista	Faktori i ndikimit më 2006	Artikuj më 2006
<i>Hydrometallurgy</i>	1.227	118
<i>Minerals Engineering</i>	0.942	197
<i>Metallurgical & Materials Trans. B</i>	0.910	107
<i>JOM</i>	0.887	113
<i>International Journal of Mineral Processing</i>	0.884	95
<i>Powder Technology</i>	0.553	53
<i>Canadian Metallurgical Quarterly</i>	0.234	42
<i>Minerals & Metallurgical Processing</i>	0.191	24
<i>Coal Preparation</i>	0.179	14
<i>J. S. African IMM</i>	0.124	94

në disa disiplina shkencore të afërta, p.sh.: shkencat e natyrës, shkencat e inxhinierisë, shkencat shoqërore etj. Referimin e numrit më të madh të revistave (5900) nga fusha e shkencave të inxhinierisë e publikon Instituti për Informata Shkencore (ISI), Filadelfia, SHBA, nëpërmjet bazës së të dhënave: *Science Citation Index (SCI)*.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet t'u mundësojë qasjen në këto baza të të dhënave institucioneve akademike dhe shkencore:

- **Current Contents (CC)**, me rreth 7500 revista shkencore dhe mbi 2000 tituj librash dhe përmbledhje nga tubimet shkencore të fushave të inxhinierisë dhe të tjera;

- **Web of Science (WoS)**, me më shumë se 8700 revista shkencore, e cila e bën bashkimin e tri bazave të të dhënave: Science Citation Index (SCI), Social Sciences Citation Index, (SSCI) dhe Arts & Humanities Citation Index (AHCI);

- **Journal Citation Reports (JCR)**, me rreth 7500 revista shkencore. Bazohet në të dhënat nga SCI dhe SSCI dhe është krijuar në vitin 1975 nga E. Garfield. Ndihmon në radhitjen, vlerësimin, kategorizimin dhe krahasimin e revistave.

- **Scopus**, që nga viti 2004 indekson (referon, përgatit), më shumë se 14000 revista shkencore të recensuara nga shkencat e natyrës, shkencat e inxhinierisë dhe shkencat shoqërore, 28 milionë abstrakte, 750 përmbledhje nga

konferencat dhe kongreset, 245 milionë referenca, më shumë se 13 milionë patenta, mbi 4000 botues etj.

Ekzistojnë edhe baza të tjera të të dhënave, të cilat referojnë revista shkencore me recension, të cilat mund të shfrytëzohen si baza të të dhënave me interes për shkencën nga fusha të caktuara.

Referimi i autorëve dhe revistave shkencore në këto baza të të dhënave ka traditë dhe është bërë sot adresa kryesore për evaluimin e cilësisë së punës shkencore, gjegjësisht të revistës shkencore.

Vlerësimi i revistës shkencore në vendet me treg të vogël shkencor kryesisht mund të bëhet duke e zhvilluar dhe ndërtuar një rrjet nacional ose rajonal të citimit me faktor të ndikimit (FN) përkatës me vlerësimin e eksperteve për kriteret e funksionimit të revistës dhe me ndërtimin e bazës shkencore bibliografike të të dhënave, të cilët ofrojnë të dhëna për numrin e punimeve dhe citimin e tyre (Tab. 1).

Cilësia e një reviste pa dyshim është pozita e saj në bazën e të dhënave ISI. Kërkesa që parashtrohet ISI për referimin e një reviste shkencore në këtë bazë bibliografike të të dhënave, të cilat edhe mund të merren si elemente për vlerësimin e saj, janë:

- numri i përgjithshëm i citimeve në bazën ISI
- faktori i ndikimit (FN)
- elementet e referimit (koha e botimit, numri i punimeve etj.)

- plotësimi i standardeve dhe rregullave ndërkombëtare për botim
- emërtimi, të dhënat bibliografike për autorët e punimeve
- recensimi i punimeve dhe niveli i recensentit
- këshillat e botimit dhe reputacioni i tyre
- hapësira që mbulohet
- përkatësia nacionale (shteti) e autorëve dhe recensentit
- gjuha në të cilën botohet revista etj.

4. Gjendja e publikimeve dhe vlerësimit të punës shkencore në Kosovë

Puna shkencore dhe pozita e saj në shoqëri ka një historik të gjatë dhe është zhvilluar në etapa të ndryshme me intensitet gjithashtu të ndryshëm. E përbashkët për të gjitha këto faza është se shkencës i jepet prioritet në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë, zhvillim ky i mbështetur në baza shkencore.

Besoj se citati i presidentit të SHBA-së Bush (më 2006) në vijim është edhe një argument shtesë që të kuptojmë se sa e madhe është rëndësia e punës hulumtuese-shkencore për secilin vend:

“Investimi në punën hulumtuese-shkencore dhe në zhvillim mundëson që te ndërmerri amerikan të zhvillohet shpirti inovativ dhe siguron që ekonomia jonë të këtë profesionistë me kualifikime të larta në fushat e matematikës dhe shkencave natyrore, që paraqet bazën e një prosperiteti të qëndrueshëm ekonomik”.

Pozita e shkencës në vendet e zhvilluara dhe ato postkomuniste dallon si në aspektin sasior ashtu edhe në atë të cilësisë. Ky dallim është si rezultat i zhvillimit ekonomik dhe trajtimit nacional të kësaj çështjeje.

Kosova në këtë tranzicion dallon edhe nga vendet postkomuniste sepse fazën e tranzicionit e ka më të vështirësuar se shtetet e tjera të ekonomisë së planifikuar, si rezultat i pozitës së statusit politik të pazgjidhur.

Në këtë fazë që ndodhet shoqëria kosovare ende nuk ka një mjedis të përshtatshëm institucional, të mos themi vetëdije të opinionit të gjerë për rëndësinë dhe favorët e punës shkencore për zhvillimin e përgjithshëm të një vendi. Kjo është edhe normale sepse në Kosovë nuk ka ndonjë traditë të shënuar në këtë drejtim. Ligji për punë shkencore-hulumtuese, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2004, është një dokument që nuk e favorizon shumë këtë aktivitet.

Mbështetja financiare e paraparë sipas ligjit prej 0.9% është e vogël, por, për një buxhet që e ka Kosova, nuk është për t'u nënçmuar. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve ndahet për shkencat shoqërore (Akademia e Shkencës, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë), institucione që edhe me ligj cilësohen si “primare”, por me rezultate modeste nga fushëveprimi i tyre. Për punën shkencore nga fusha e inxhinierisë (institutet e njësive akademike), mjetet e ndara janë vetëm për

punë individuale shkencore (pjesëmarrje në tubime shkencore jashtë vendit).

Rregullat ligjore:

Në statutin e Universitetit të Prishtinës (UP), neni 182, al. 2, shkruan:

“Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike kandidati duhet të ketë këto kualifikime...”, dhe vazhdon,

2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me [nënvizimet janë tonat!]:

a. një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore dhe publikimeve të rishqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare;

b. pjesëmarrje aktive në konferencat ndërkombëtare;

c. krijime a punime te njohura artistike ose të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar kur është rasti i Fakultetit të Arteve; në mënyrë të veçantë duhet të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit

d. përvojë afatgjatë në projekte kërkimesh themelore dhe të aplikueshme

3. aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme

4. aftësi bindëse për udhëheqje akademike

5. për mbikëqyrje të temave post-diplomike dhe të doktoratës.

Si do të matej kjo kompetencë? Sipas këtyre pozicioneve, nuk mjaftojnë shprehjet: të tregojë nivel, të rëndësishme, një numër të rëndësishëm publikimesh të rishqyrtuara dhe të shqyrtuara (*përkthim i gabuar*), aftësi të lartë etj.

Ky nen mund të jetë funksional nëse do të përpilohej një rregullore shtesë e cila bën vlerësimin sasior në bazë të të dhënave bibliografike, krahas vlerësimit cilësor dhe caktohen pikët për secilën punë shkencore, profesionale dhe pedagogjike. Enjëjtë është situata edhe në nenin 38 (1, 2, 3) të LIGJIT PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE SHKENCORE të Kosovës (2004)

Baza bibliografike

Institucionet e Kosovës nuk disponojnë më bazë të dhënave bibliografike, si:

numri i punimeve shkencore të publikuara në revista referative (indeksuara), revista shkencore të referuara në bazën e të dhënave bibliografike (p.sh. në SCI), krahasimi i këtyre të dhënave me vendet e rajonit, pjesëmarrja e punonjësve shkencorë në tubimet (konferencat, simpoziumet, kongreset etj.) shkencore në vend dhe jashtë vendit.

Vlerësimi i punës shkencore

Ky vlerësim bëhet pa metodologji të përcaktuar. Nga e gjithë fusha e përcaktuar për vlerësim sipas nenit 182, për vlerësim nga “kompetentët” merret vetëm publikimi në revistat ndërkombëtare.

bëtare. Pra edhe dokumentet me të cilat administrohet universiteti nuk respektohen. Nuk bëhet vlerësimi me të dhëna objektive bibliografike (numri i publikimeve, faktori i ndikimit të revistave ku është publikuar punimi etj.)

Në 2004, sipas Strategjisë së zhvillimit të lartë në Kosovë (2005-2015), është dashur të arrihen këta tregues:

- Paketa ligjore për zhvillimin e shkencës
- Programi afatmesëm i Qeverisë për zhvillimin e shkencës
- Numër i mjaftueshëm i kërkimeve shkencore të cilat kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë
- Ngritja e sistemit pasuniversitar sipas objektivave të Procesit të Bolonjës
- Numër i mjaftueshëm i publikimeve me recension ndërkombëtare
- Fonde të veçanta për punë kërkimore-shkencore, ngrihet infrastruktura institucionale për punë shkencore,

Revistat shkencore

Vlerësimi sasior dhe cilësor të revistave shkencore në Kosovë realisht nuk ka. Nuk ka as kushte as interes që të fillohet më një projekt të tillë, pra as për vlerësim objektiv të këtij aktiviteti. Edhe ato revista që ishin nëpër njësitë akademike dhe institucionet e tjera janë lënë në mëshirën e tekeve. Vendi i publikimit të punës shkencore shpesh caktohet jo drejt dhe në mënyrë të njëanshme, pa mbështetje në kritere shkencore sistematike për vlerësim. Në Strategjinë e zhvillimit të lartë në

Kosovë (2005-2015), as që bëhet fjalë për nxjerrjen e ndonjë reviste, ose fuqizimin e revistave ekzistuese.

Përfundim

Përfundimi i parë është se kjo gjendje në tërë zinxhirin e punës shkencore humltuese duhet ndryshuar sa më parë. Kjo behët duke filluar nga organizimi, rregullat ligjore, përkrahja financiare sipas modelit të vendeve të zhvilluara. Kjo edhe na detyron për integrimin e vendit në BE. Ndihmë të madhe në këtë stabilizim të gjendjes në fushën e punës shkencore duhet pritur nga shkencëtarët e vendit që janë të përfshirë në rrjedhat e shkencës botërore.

Vlerësimi i punës dhe i revistës shkencore duhen bërë sipas normativave të mbështetura në modelet e vendeve me treg shkencor të zhvilluar.

Deri sot nuk disponojmë me ndonjë kriter të përsosur për vlerësimin, cilësor dhe sasior, të punës shkencore, e sa më shumë kritere që shfrytëzojmë, vlerësimi është më objektiv.

Kriteret për vlerësimin e punës shkencore nuk duhen parë si diçka abstrakte dhe të izoluar nga pozita shoqërore e shkencës dhe e punonjësit shkencor. Ato duhen caktuar nga institucionet e shtetit dhe nga institucionet akademike kërkohet t'i zbatojnë në praktikë. Vetëm atëherë kur kemi metodologjinë e vlerësimit të matshme dhe kontinuale do të mund të kemi vlerësim objektiv për punën dhe revistën shkencore. Në këtë mënyrë kjo

fushë nuk mbetet e izoluar dhe nuk mund t'i bëhet interpretim nga pozita dhe momenti i analizës. Është koha e fundit që të flasim me të dhëna të besuara, të normuara dhe transparente për të gjithë, subjektivizmi ngushtohet dhe sa më parë që bëhet kjo, aq më shpejt do të mund të përfshihemi në rrjedhat e shkencës botërore.

Të mbështetemi në vlerësimin e punës shkencore vetëm në numrin e punimeve të botuara në "revistat ndërkombëtare" është vlerësim jo objektiv dhe i pashtjelluar sa duhet, të cilit i mungojnë shumë elemente.

Etika shkencore është veti e punës shkencore, e cila duhet të jetë e pranishme në çdo vlerësim. Normat etike në secilin nga treguesit cilësorë dhe sasiore të punës shkencore duhet të respektohen dhe janë vlera universale për secilin punëtor shkencor.

Bibliografia

1. Garfield E, *How ISI selects journals for coverage: Quantitative and qualitative considerations*, Current Contents 1990; 22 (May 28): 5-13.
2. J. Petrak, *Bibliometriki pokazatelji i ocjenjivanju znastvenog rada*, Medicinski fakultet, Sveučilišta u Zagrebu, Zagreb, Croatia.
3. ... *The ISI Essays. Journal Citation Reports. The impact factor*: Institute for Scientific Information. <http://www.isinet.com/essays/journalcitationreports> (2004-04-26).
4. K.-F. Kaltenborn, K. Kuhn, *The journal impact factor as a parameter for the evaluation of researchers and research*, Institut für Medizinische Informatik. Fachbereich Medizin und Klinikum. Philipps-Universität Marburg, Marburg, Germany.
5. P. Gašparac, *The role and relevance of bibliographic citation databases*, Central Library, School of Pharmacy and Biochemistry, University of Zagreb, Zagreb, Croatia.